

VENDIM
Nr.885, datë 3.11.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.431, DATË 11.12.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË GRAMSH, TË QARKUT TË ELBASANIT”, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.818, DATË 6.12.2006 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 7, 17 e 14/a të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e një shtese në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të bashkisë Gramsh, që i bashkëlidhet vendimit nr.431, datë 11.12.2007 të Këshillit të Ministrave, sipas lidhjes nr.1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Lista, që fillon me numrin rendor 501 (pesëqind e një) dhe përfundon me numrin rendor 503 (pesëqind e tre), ka gjithsej 2 (dy) fletë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, që i bashkëlidhet vendimit nr.818, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, hiqen pronat “Dega e tatimeve (administratë)”, Gramsh, me sipërfaqe të përgjithshme 384 (treqind e tetëdhjetë e katër) m² dhe ndërtesë 200 (dyqind) m², dhe “Dega e tatimeve (garazh)”, Gramsh, me sipërfaqe të përgjithshme 66.9 (gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntë) m² dhe ndërtesë 66.9 (gjashtëdhjetë e gjashtë pikë nëntë) m².

3. Në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, të bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit që i bashkëlidhet vendimit nr.431, datë 11.2.2007 të Këshillit të Ministrave, hiqet prona me numër 239, truall i lirë, me numër pasurie 6/54 dhe me sipërfaqe 541.5 (pesëqind e dyzet e një pikë pesë) m².

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Gramsh, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Gramsh		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
501, 502, 503	Prona që përdoren në fushën e administratës	Në pronësi